



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 11.02.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 09.02.2021 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Toifor SHPK" për aktivitetin: "Mirembajtja dhe rindertimi i kanalizimit atmosferik në Komunen e Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: **616 -20-7123-211** nxjerr:

V E N D I M

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "Toifor SHPK" e datës 09.02.2021 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirembajtja dhe rindertimi i kanalizimit atmosferik në Komunen e Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: **616 -20-7123-211**, kundër Njoftimit për Vendimin e AK-se të datës 05.02.2021, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.

1. Vërtetohet Njoftimi për Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 05.02.2021;
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "TOIFOR SHPK" me datë 09.02.2021 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirembajtja dhe rindertimi i kanalizimit atmosferik në Komunen e Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: **616 -20-7132-211**.

Autoriteti Kontraktues, me datë 11.02.2021 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimi juaj është se Autoriteti Kontraktues ka refuzuar tenderin tuaj si tender me çmimin me të ulët. Lidhur me këte ju sqarojme:

Pajtohem se parimi baze i prokurimit është shfrytëzimi efikas i fondeve publike dhe lidhur me këte ka rregulla të percaktuara qarte jo vetëm për çmimet jonormalisht të ulta, por edhe për çmimet me të larta nga çmimi i tregut, e që është me e rëndësishme për trajtim sipas të nejtutit parim. Lidhur me këte aktivitet dua t'ua perkujtoj një fakt që sigurisht e dini edhe ju: në disa pozicione ju keni vendosur çmime shumë me të larta se sa çmimi i tregut e sidomos në dy pozicione: 2.1 a dhe 2.1 qe kanë të bëjnë me germimin me makina dhe me germimin me dore ku keni dhënë çmim prej 50.00 euro për pozicionin e parë dhe çmim prej 30.00 euro

per pozicionin e dyte. Se detyrim kryesor per zyrtarin e prokurimit eshte qe te mos pranohen çmime me te larta nga çmimi i tregut eshte e percaktuar ne piken 4.2 e Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ per Prokurim Publik ky eshte percaktuar si vijon:

4.2 Gjatë administrimit të procedurave të prokurimit, AK do të ketë obligimet në vijim: a) të luaj rolin aktiv në përcaktimin e kushteve të kontratave, me theks të veçantë për çmimet, afatet e dorëzimit, sasi të, karakteristikat teknike dhe garancive; b) për aq sa është e mundshme në bazë të rrethanave, të bëhet krahasimi efektiv i kërkesave për pjesëmarrje dhe tenderëve për të përcaktuar avantazhet e tyre relative dhe disavantazhet, dhe c) të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut.

Lidhur me kete ka edhe nje interpretim te KRPP-se ne baze te kerkeses se nje Autoriteti Kontraktues lidhur me çmimet me te larta se çmimet e tregut te cilin ua paraqes ne vijim:

From: Rregullat Krpp <Rregullat.Krpp@rks-gov.net>

Sent: Thursday, December 24, 2020 9:25 AM

Të nderuar,

Konform nenit 87, paragrafit 2, nënparagrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjen e parashtuar, KRPP sqaron si në vijim:

Sa i përket **çështjes së ofrimit të çmimeve më të larta se çmimet reale të tregut**, KRPP sqaron se kjo çështje nuk është e rregulluar me ndonjë dispozitë të veçantë në ligj dhe legjislacionin dytësor, megjithatë KRPP konsideron se gjatë vlerësimit të tenderëve Autoritetet Kontraktuese, çdo herë duhet të mbajnë në mend qëllimin e Ligjit të Prokurimit Publik të përcaktuar me paragrafin 1 të nenit 1 të LPP-së, i cili përcakton:

“Qëllimi i këtij ligji është të

sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë...”

Gjithashtu,

Autoritetet kontraktuese **duhet të sigurohen** që gjatë administrimit të procedurave të prokurimit të mos kontraktojnë me çmime më të larta se çmimet reale të tregut. Shih nenin 4.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, i cili përcakton:

“4.2 Gjatë administrimit të procedurave të prokurimit, AK do të ketë obligimet në vijim:

- a) të luaj rolin aktiv në përcaktimin e kushteve të kontratave, me theks të veçantë për çmimet, afatet e dorëzimit, sasi të, karakteristikat teknike dhe garancive;***
- b) për aq sa është e mundshme në bazë të rrethanave, të bëhet krahasimi efektiv i kërkesave për pjesëmarrje dhe tenderëve për të përcaktuar avantazhet e tyre relative dhe disavantazhet, dhe***
- c) të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut.”***

Duke u bazuar ne te njejtat dispozita dhe interpretime ne kemi kerkuar sqarime shtese lidhur me ate si si kane ardhur deri te ato cmime nga te gjitha tenderuesit qe kane dhene çmime te tilla, duke ju perfshire edhe ju.

Pasi qe pothuajse te gjitha tenderuesit ne pergjegjet e tyre jane arsyetuar me faktin se pershkrimi i pozicionit eshte i pa qarte sepse ne te njejtin jane perfshire germimi i kategorive te ndryshme te dheut: nga kategori e III-te deri ne te VI-ten dhe ate germimin me

dore, makineri, çekan dhe transporti me ngarkim shkarkim, me thellesi mesatare të germimit 2.35 metra dhe gjerësi sipas profilit të gypave (gypat 250-630 mm). Pas kësaj është analizuar në teresi ky përshkrim dhe është konstatuar se në të njëjtin janë përfshirë pozicione të ndryshme që kanë edhe çmime të ndryshme. Pasi që ka shumë pozicione të cilat nuk janë paraqitur koheve të fundit në ofertat e pranuar për të analizuar këto çmime jemi bazuar në çmimet referente nga manuali i KRPP-së. Sipas këtyre çmimeve është konstatuar se të njëjtat janë si vijon: për kategorinë e III-të çmimi me transport deri në 10 kilometra është 4.40 euro, për kategorinë e IV-të 4.26 euro, për kategorinë e V-të çmimi me çekan çmimi është 16.36 euro, ndërsa për kategorinë e VI-të 22,27 euro. Për dy kategoritë e fundit duhet shtuar edhe transportin 2.44 euro dhe kemi për kategorinë e V-të çmimin prej 18.70 euro dhe për kategorinë e VI-të 24.71 euro. Pasi që të gjitha këto pozicione janë përfshirë në një përshkrim rrjedh se çmimi mesatar për germim me eskavator është $(4.40 + 4.54 + 18.70 + 24.71) : 4 = 13.09$ euro. Duke marrë parasysh se këtu mund të kemi rastet kur transporti mund të jetë në largësi me të mëdha dhe se nuk dihet proporcioni i kategorive të parapara për germim konstatohet se çmimi maksimal i pranueshëm për germim me eskavator nuk mund të kalojë në asnjë rast çmimin prej 15.00 për m³. Poashtu për çmimin me dorë është dashtë të bazohemi në çmimet referente, por për këto kemi vetëm çmimin për kategorinë e III-të e jo për kategoritë e tjera. Për këto kategori çmimi për germim është 10.50 euro dhe marrë për baze edhe shpenzimet mesatare për ngarkim dhe transport prej 3,00 euro rrjedh se çmimi për këto pozicion është 13.50 euro. Bazuar në këto konstatohet se çmimi maksimal i pranueshëm për këto kategori për germim me dorë mund të jetë 14.00 euro. Pra nga kjo analizë rrjedh se çmimi maksimal që mund të pranohet për këto pozicione është për çmimin me eskavator 15.00 euro, ndërsa për çmimin me dorë 14.00 euro. Bazuar në faktin se nga praktika dihet se në ofertat tuaja zakonisht vendosni çmime me të ulta nga çmimet referente kemi konstatuar se ato çmime paraqesin pragun maksimal për pranimit dhe çdo çdo çmim i pranuar me lartësi do të ishte mbi çmimin e tregut dhe si i tillë edhe në kundërshtim me parimin bazë të LPP-ik.

Nga analiza jone mund të vereni se janë marrë për baze të gjithë parametrat nga përshkrimi i pozicionit dhe çmimet tuaja për ato dy pozicione nuk kanë mund të trajtohen si të pranueshme, pasi që janë shumë me të larta se sa çmimet e tregut.

Bazuar në sqarimet e dhëna për pretendimet tuaja u vendos si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

